



me ____ . ____ .2021

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

Për: ASI-2A CO SHPK me adrese ne Fier Fier FIER Rruga Skenderbeu, Lagjia Bishanake, pallati nr 18, hyrja nr. 6

Procedura e prokurimit: Kerkese per propozim -Mallra

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-85252-01-29-2021

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Blerje Tubo me diameter me presione te ndryshme dhe materiale hidraulike”

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. “Ardit Ceka”

L78319502A

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera 2276990 (dy milion e dyqind e shtatedhjetë e gjashtë mijë e nentëqind e nentëdhjetë) leke (pa tvsh).

2. “ASI-2A CO”

K53002402C

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera 2408453 (dy milion e katerqind e tete mijë e katerqind e pesëdhjetë e tre) leke (pa tvsh).

3. “WAT 2010”

L02017001Q

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera 1857500 (nje milion e teteqind e pesëdhjetë e shtate mijë e peseqind)leke (pa tvsh).

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. “Ardit Ceka”

L78319502A

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

2. “WAT 2010”

L02017001Q

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Përkatësisht për arsytet e mëposhtme:

“Ardit Ceka”

1. Ne kerkesat per kualifikim percaktohet: *2.2.2 Operatori Ekonomik duhet të kete nje aktivitet pozitiv të qendrueshëm gjate tre viteve (2017, 2018 dhe 2019). Për të vertetuar plotësimin e ketij kushti Operatori Ekonomik duhet të paraqesë kopjet e çertifikuara të bilanceve të këtyre tre viteve, të paraqitur pranë autoritetit përkatës, si dhe të shoqeruara nga akt ekspertiza e kryer nga Eksperti kontabël i autorizuar.* OE ekonomik ofertues ka paraqitur 3 flet bilanci te 3 viteve te ndryshme te cilat nuk jane as te certifikuara nga autoritetet perkatese dhe as me vulen elektronike perkatese. Ndaj sa me siper OE nuk e ka plotesuar kushtin e mesiperm.
2. Ne kerkesat per kualifikim percaktohet: *2.3.1 Operatori ekonomik duhet te paraqese dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, me vlerë sa 40% e vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit. Kontratat e ngjashme të jenë te shoqeruar me vertetimin e realizimit nga autoriteti kontraktor ose me subjekte private te paraqiten faturat përkatëse tatimore te shitjes ku shenohen datat, shumat dhe sasite e mallrave te furnizuara.* Sa me lart konstatohet se ne rastin e kontratave me autoritete kontraktor per te plotesuar kerkesen e mesiperme nevojiten: *Kontratat e ngjashme të jenë te shoqeruar me vertetimin e realizimit nga autoriteti kontraktor.* OE pjesemarre ka sjelle per plotesimin e kerkeses se mesiperme: 1. fature tatimore me nr. 02 date 24.10.2017 me Sh.a Ujesjelles Kanalizime Fier me vlere 398000 leke pa TVSH, (Jashte afatit 3 vjecar) 2. Fature nr. 14 date 12.03.2018 me Sh.a Ujesjelles Kanalizime Skrapar me vlere 324000 leke pa TVSH, 3. Fature nr. 16 date 30.03.2018 me Sh.a Ujesjelles Kanalizime Lushnje me vlere 528000 leke pa TVSH, 4. Fature nr. 29 date 16.10.2018 me Sh.a Ujesjelles Kanalizime Puke me vlere 276000 leke pa TVSH, 5. Fature nr. 1 date 16.10.2018 me Sh.a Ujesjelles Kanalizime Lushnje me vlere 64000 leke pa TVSH, 6. Fature nr. 18 date 17.04.2018 me Sh.a Ujesjelles Kanalizime Gramsh me vlere 308000 leke pa TVSH. Gjithashtu jane paraqitur disa lista materialesh (pjese e ofertes ne prokurim). Sa me lart kontatohet se dokumentacioni i paraqitur nuk e ploteson kerkesen per kualifikim pasi ne DST percaktohet tekstualisht: *Kontratat e ngjashme të jenë te shoqeruar me vertetimin e realizimit nga autoriteti kontraktor.* Paraqitja e faturave tatimore nuk verteton realizimin me sukses te kontrates perkatese ndaj sa me siper OE nuk e ka plotesuar kushtin e mesiperm.
3. Ne kerkesat per kualifikim kerkohej: *-Autorizim Prodhuesi ndersa OE ka paraqitur autorizim Distributori pra nje shoqeri e cila nuk ka paraqitur dokumentacion njohes per aktivitetin e shoqerise por qe deklarone se eshte e autorizuar nga prodhuesi pra nuk eshte prodhues sic kerkohej ne DST.*

4. Po keshu per kete efekt dhe dokumentacioni tjetër I kerkuar: *-Certifikate Konformiteti-Certifikate qe eshte ne perputhje me normativat e standartit EN12201-Certifikate DVGW per teste laboratorike qe verteton se tubat jane per perdorim per uje te pijshem-Certifikate per te vertetuar se tubat e ujit te pijshem jane rezistent ndaj presioneve te deklaruar.*-Katalog Teknik bien poshte pasi ato nuk jane pjese e dokumentacionit nga prodhuesi tek ofertuesi por per nje pale te trete ne kundershtim me DST.
5. Ne kerkesat per kualifikim kerkohej: ***-Operatori ekonomik, perpara hapjes së ofertave, duhet të paraqesë mostra të mallrave që ofron, që duhet të përmbushin specifikimet teknike. Mosdorëzimi i mostrave deri në momentin e hapjes së ofertave, është kusht për skualifikim.*** Ne rastin konkret OE ofertues nuk ka paraqitur mostra te mallrave qe ofron ne kundershtim me DST.

“ Wat 2010 ”

1. Operatori ekonomik nuk ka paraqitur asnje nga kriteret e pergjithshme dhe te vecanta per kualifikim pervec ofertes ekonomike.

1. Ne kerkesat per kualifikim percaktohet:

b. Deklarate për paraqitje oferte të pavaruar, sipas Shtojcës 2/1;

c. Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës sipas Shtojcës 5/1;

ç. Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 6;

d. Deklaraten mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;

dh. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. Ne rastin konkret OE nuk i ka plotësuar kushtin e mesiperm.

2. Ne kerkesat per kualifikim percaktohet:

2.2.1 Xhiro mesatare e realizuar nga Operatori Ekonomik gjate tre viteve (2017, 2018 dhe 2019) duhet të mos jetë më e vogël se vlera e fondit limit të tenderit. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kushti, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një vërtetim nga Dega e Tatim Taksave, për xhiron vjetore të realizuar për të 3 (tre) vitet ku vlera mesatare e tyre të mos jetë më e vogël se vlera e fondit limit.

2.2.2 Operatori Ekonomik duhet të kete nje aktivitet pozitiv të qendrueshëm gjate tre viteve (2017, 2018 dhe 2019). Për të vertetuar plotësimin e këtij kushti Operatori Ekonomik duhet të paraqesë kopjet e çertifikuara të bilanceve të këtyre tre viteve, të paraqitur pranë autoritetit përkatës, si dhe të shoqeruara nga akt ekspertiza e kryer nga Eksperti kontabël i autorizuar. Sa me lart kontatohet OE nuk ka paraqitur asnje nga kriteret e kerkuara ndaj sa me siper OE nuk e ka plotësuar kushtin e mesiperm.

3. Ne kerkesat per kualifikim percaktohet:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, me vlerë sa 40% e vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit. Kontratat e ngjashme të jenë të shoqeruara me vërtetimin e realizimit nga autoriteti kontraktor ose me subjekte private të paraqiten faturat përkatëse tatimore të shitjes ku shenohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

- Certifikate Konformiteti
- Certifikate qe eshte ne perputhje me normativat e standartit EN12201
- Certifikate DVGW per teste laboratorike qe verteton se tubat jane per perdorim per uje te pijshem
- Certifikate per te vertetuar se tubat e ujit te pijshem jane rezistent ndaj presioneve te deklaruar.
- Autorizim Prodhuesi
- Katalog Teknik

Sa me lart kontatohet OE nuk ka paraqitur asnje nga kriteret e kerkuara ndaj sa me siper OE nuk e ka plotesuar kushtin e mesiperm

4. Ne kerkesat per kualifikim kerkohej: **-Operatori ekonomik, perpara hapjes së ofertave, duhet të paraqesë mostra të mallrave që ofron, që duhet të përmbushin specifikimet teknike. Mosdorëzimi i mostrave deri në momentin e hapjes së ofertave, është kusht për skualifikim.** Ne rastin konkret OE ofertues nuk ka paraqitur mostra te mallrave qe ofron ne kundershtrim me DST.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **ASI-2A CO SHPK me adrese ne Fier Fier FIER Rruga Skenderbeu, Lagjia Bishanake, pallati nr 18, hyrja nr. 6** se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **2408453 (dy milion e katerqind e tete mije e katerqind e pesedhjete e tre) leke (pa tvsh)** pikët totale të marra [_____] është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Ujesjelles Kanalizime Belsh sha Rruga Belsh-Kosove, Kilometri 5, Fshati Cepe, Ish-shkolla 9-vjecare E - mail: ujesjelleskb@gmail.com Nr.Kontakti 068 64 16 064** sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda **5 (pese) ditëve** nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej -, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë **17.02.2021**

Ankesa: ka ose jo_ (**nuk ka**)

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR /OSE PERSONI I
AUTORIZUAR PREJ TIJ
Endri PEPA**